



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1476/2 Prot.

Tiranë, më 30.11.2022

V E N D I M

Nr. 209, Datë 30 . 11 . 2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr. 174 Regj., datë 18.11.2022, të shtetasit E. P, kundër Kompanisë “Xh & M Construction sh.p.k”, me objekt pretendimin e diskriminimit për shkak të “etnisë” dhe “gjendjes shëndetësore”.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

KONSTATOI:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në parashtrimet dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi nga subjekti ankues, E. P, rezulton se ai:

Është pajisur me leje qëndrimi në shtetin e Maqedonisë së Veriut për periudhën 18.11.2018 deri më datë 06.11.2019, leje të cilën e ka përfituar nga autoriteti përgjegjës për efekt punësimi, kontraktuar nga Kompania “Xh & M Construction” në cilësinë e punëdhënësit.

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD ose si Komisioneri.

Ankuesi është shprehur se gjatë kësaj periudhe ka realizuar punën në këtë shtet për muajt Shkurt, Mars, Prill, Maj 2019 dhe se pagesa për punën e kryer është në vlerën 270.000 lekë, nga të cilat pretendon se janë paguar vetëm 70.000 lekë nga punëdhënësi.

Ankuesi shprehet se, lidhur me këtë problematikë ka komunikuar disa herë nëpërmjet telefonit me F. M, përfaqësuesin e Kompanisë dhe financieren E. Q, por ende dhe aktualisht nuk ka gjetur zgjidhje.

Ai i është drejtuar për ndihmë Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Vlorë, duke u shprehur se pas ndërhyrjes së kësaj Qendre është mundësuar që atij t'i depozitohet në llogarinë bankare shuma prej 40.000 lekësh nga Kompania, duke mos marrë kështu ende shumën e plotë, duke pretenduar se Kompania duhet t'i shlyejë pagesën e prapambetur prej 160.000 lekësh.

Ankuesi i është drejtuar edhe Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (IShPSHSh), i cili nëpërmjet shkresës me nr. 5244/1 prot., datë 02.11.2022, i ka kthyer përgjigje duke e informuar atë, ndër të tjera se, pas shqyrtimit të ankesës ndaj Kompanisë "Xh & M Construction", rezulton se ai është deklaruar për periudha të ndryshme me kohëzgjatje të shkurtër pranë këtij subjekti.

Për vitin 2018 nuk rezulton i deklaruar në këtë subjekt, por ankuesi rezulton i deklaruar nga data 29.03.2019-03.04.2019 dhe se gjithashtu deklarimi në formularin Esig 25, listëpagesa e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore përkon në po këto data.

IshPSHSh ka informuar ankuesin, ndër të tjera, se:

"Për periudhën që ju pretendoni se keni qenë i punësuar në shtetin e Maqedonisë së Veriut, nga kontrolli i ushtruar dhe dokumentacioni i verifikuar nuk mundëm të vërtetojmë pretendimin tuaj. Edhe nëpërmjet bisedës telefonike mes nesh ju pranuat që nuk keni asnjë dokument ku të mbështesni ankesën tuaj, pasi keni pranuar të punoni në mirëbesim.

Kontrata e punës e lidhur mes palëve, është një dokument i rëndësishëm për të rregulluar marrëdhënien e punësimit dhe në zbatim të saj përcaktohen detyrimet që palët kanë ndaj njëra-tjetrës. Në mungesë të këtij dokumenti e kemi të pamundur të zgjidhim ankesën në favorin tuaj. Për çdo pretendim sugjerojmë t'i drejtoheni organeve gjyqësore për të fituar të drejtën e cila është mbi palët dhe ka në kompetencë të verifikojë sa pretendoni".

Subjekti ankues ka pretenduar se është diskriminuar nga Kompania, pasi prej kohësh ajo i ka mohuar të drejtën e pagës për punën e kryer, për shkak të etnisë së tij, si pjesë e minoritetit egjiptian dhe për shkak të gjendjes ekonomike për të cilën thotë se e ka të pamundur të ndjekë këtë çështje në rrugë private e gjyqësore. Ai është shprehur se edhe dy nga kolegët e tij ndodhen në situatë të njëjtë me të, që nuk u është bërë pagesa e plotë njëlloj si atij nga ana e kësaj Kompanie.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit nga ana e Kompanisë “Xh & M Construction” për shkak të etnisë dhe gjendjes ekonomike të tij.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ofron mbrojtje nga diskriminimi. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së dhe parashtrimeve të tij, Komisioneri konstaton se::

- Ankuesi ka qenë i pajisur me leje qëndrimi në shtetin e Maqedonisë së Veriut për periudhën 18.11.2018-06.11.2019, për efekt punësimi, kontraktuar nga Kompania “Xh & M Construction” në cilësinë e punëdhënësit.
- Ai është shprehur se gjatë kësaj periudhe ka qenë i punësuar pranë kësaj Kompanie dhe se për muajt Shkurt, Mars, Prill, Maj 2019 nuk është realizuar pagesa nga punëdhënësi për punën e kryer prej tij.
- Në muajin Qershor 2019 është kthyer në Shqipëri *(në përfundim të lejes së qëndrimit për efekt punësimi)* dhe ka pritur që nga ana e punëdhënësit të përmbushet detyrimi i pagesës së tij për punën e realizuar në favor të Kompanisë; detyrim i cili vazhdon të mbetet i papërmbushur akoma plotësisht.
- Subjekti ankues ka deklaruar se nuk është paguar nga punëdhënësi në vlerën e plotë për punën e kryer prej tij dhe se Kompania i detyrohet atij në shumën 160.000 lekë.
- Pavarësisht natyrës së marrëdhënieve të punës mes palëve: ankuesit dhe Kompanisë, e drejta e punëmarrësit për t’u shpërblyer lidhur me punën e kryer në favor të punëdhënësit është një detyrim ligjor për punëdhënësin që rregullohet nga legjislacioni i punës në Republikën e Shqipërisë dhe kryesisht nga Kodi i Punës.
- Komisioneri vëren se, lidhur me faktin e mospagesës nga ana e punëdhënësit, subjekti ankues, ka ardhur në dijeni që në muajin Qershor 2019, periudhë në të cilën pagesa duhet të ishte realizuar, sjellje kjo e Kompanisë, të cilën e ai e ka konsideruar veprim diskriminues ndaj tij.
- Në kontekst të sa mësipër, **ankuesi ka marrë dijeni për mospagimin e pagës për punën e kryer prej tij në kuadër të marrëdhënieve të punës me Kompaninë Xh & M Construction”** *(pavarësisht natyrës së marrëveshjes së marrëdhënieve të punës së realizuar mes palëve: të formalizuar me kontratë individuale pune apo kontratë verbale dhe në mirëbesim)*, fakt për të cilin dhe pretendon diskriminimin, që në **muajin qershor 2019**. **Ankesa pranë KMD-së është regjistruar në datën 18.11.2022**, pra më vonë se dy vite nga marrja dijeni *(konkretisht më shumë se 3 tre vite)*.

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, shkronja dh), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se “Ankesa nuk prahohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijeni për sjelljen diskriminuese”, ankesa e shtetasit E. P, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë së janë tejkaluar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi³.

Nga aktet shkresore të depozituara nga ankuesi, rezulton se, pretendimet për mbajtje të paligjshme dhe të padrejtë të pagës, E. P i ka bërë objekt të shqyrtimit administrativ, pranë IshPSHSh dhes se do të vijojë t’i kërkojë edhe gjyqësisht.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i rekomandon subjektit ankues, t’i drejtohet për ofrimin e ndihmës ligjore falas, Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike⁴, ose Shërbimit Ligjor Falas⁵, në mënyrë që të asistohet prej tyre për procedurat gjyqësore pranë gjykatës kompetente.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 33, pika 4/dh, nenin 33, pika 10, nenin 36, pika 1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së E. P, për shkak se është jashtë afatit për shqyrtimin e ankesave, sipas parashikimit të dispozitave të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

³ Për analogji shih vendimet nr. 33, datë 07.02.2022 dhe nr. 117, datë 13.06.2022, të Komisionerit.

⁴ Me adresë: Pranë Ministrisë së Drejtësisë, Blv. “Zogu i Parë”, Tiranë.

⁵ Me adresë: Bulevardi: “Bajram Curri”, Pall: “Agimi”, Shk. 18, Ap. 322, Tiranë, Nr.tel: 0422 53113.